



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:047255

Datë: 19.09.2024

Numri i dokumentit: 06195103

KF.nr.614/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Haxhijaha Trade” sh.p.k, me seli në Rahovec, përfaqësuar nga Florim Shefqeti, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 29.08.2024 në prani të përfaqësuesit të palës paditëse Florim Shefqeti, avokat dhe përfaqësueses së palës së paditur Krenare Shala, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Haxhijaha Trade” SHPK me seli në Rahovec, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr. 01.3.2.2/293915-2021 i datës 02.03.2022.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, Haxhijaha Trade sh.p.k., me seli në Rahovec, ka paraqitur padi në Gjykatë kundër Doganës së Kosovës në Prishtinë, duke kërkuar rishikimin dhe kthimin e rivlerësimit të bërë nga Dogana e Kosovës për vendimet R-53123/01.12.2021, R-53124/01.12.2021, R-53125/01.12.2021, R-53126/01.12.2021, R-53209/02.11.2021, R-53346/02.12.2021, R-53338/02.12.2021, R-641/11.01.2022, dhe R-643/11.01.2022. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, përfaqësuesi i palës paditëse deklaroi se qëndron pranë padisë duke kërkuar anulimin e vendimit të Doganës, me arsyetimin se është në kundërshtim me nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (KDAK), duke pretenduar se gabimisht është aplikuar neni 35, përkatësisht metoda e gjashtë e vlerësimit. Gjithashtu, përfaqësuesi i paditësit në precizimin e kërkesëpadisë

ka kërkuar të anulohet vendimi i të paditurës, të detyrohet e paditura të bëjë kthimin e shumës së paguar më tepër në vlerë prej 20,809.15 euro dhe pagesën e shpenzimeve gjyqësore për përfaqësim. Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i autorizuar theksoi se vendimi i Doganës është i paligjshëm, pasi është aplikuar gabimisht neni 35 dhe jo neni 33 i KDAK-së. Kjo, sipas tij, cenon parimin e ekonomisë së lirë të tregut, duke vendosur çmime fikse që kufizojnë mundësinë e negociatave dhe janë në kundërshtim me Kushtetutën. Përfaqësuesi gjithashtu argumentoi se malli nuk është krahasuar me atë të një prodhuesi të njëjtë, çka përforcon pretendimin se vendimi është i gabuar.

E paditura në përgjigje në padi të datës 31.07.2024 si dhe përgjatë seancave gjyqësore e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare dhe se vendimi i atakuar me padi është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme relevante juridike. Andaj bazuar në thëniet e cekuara më lartë Dogana e Kosovës i propozon Gjykatës që pas administrimit të provave të marr Aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit duke lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës. Gjithashtu përfaqësuesja e palës së paditur në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pretendimet e paditësit se vlera e mallit kontestues është vlerë reale nuk qëndrojnë pasi që kemi zhdoganime me mall të njëjtë dhe vlerë më të lartë të transaksionit para dhe pas importit kontestuese, prova këto të cekura edhe në aktvendimin kontestues. Andaj i propozon gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit duke lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 29.08.2024 ka administruar provat si në vijim: Aktvendimi 01.3.2.2/23915-2021 i datës 02.03.2022, Ankesë e paditësit në Doganën e Kosovës e datë s 06.12.2021, DUD-at: R 53123/01.12.2021, Faturë CI21080667-D e datës 29.08.2021, Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave për DUD R 53123, DUD R 53124/01.12.2021, Faturë CI21080667-C e datës 29.08.2021, DUD R 53125/01.12.2021, Faturë CI21080667-B e datës 29.08.2021, Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave për DUD R 53125, DUD R 53126/01.12.2021, Faturë CI21080667-A e datës 29.08.2021, Proces mbi përcaktimin e vlerës

së mallrave për DUD R 53126, Kontrata shitblerjes e datës 02.06.2021, Swift Konfirmimi i pagesës e datës 13.07.2021 dhe 01.11.2021, DUD R 53209/02.12.2021, Faturë 21100250 c e datës 25.10.2021, Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave për DUD 53209, DUD R 53338/02.12.2021, Faturë 21100250 a, Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave për DUD R 53338, DUD R 53346/02.12.2021, Faturë 21100250 e, Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave për DUD R 53346, Kontratë në mes Wanli Group Trade Limited dhe Haxhijaha Trade Kosovo, Transfer bankar i datës 24.06.2021, Swift konfirmimi i datës 16.11.2021, Ankesë e paditësit në doganë e datës 13.01.2022, DUD R 641/11.01.2022, Faturë 21100389 b, Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave për DUD R 641, DUD R 643/11.01.2022, Faturë 21100389 d, Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave për DUD R 645, Swift konfirmimin e datës 25.11.2021, 6 Urdhërpagesa dhe transaksione me datë 11.01.2022 dhe tri të datës 02.12.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, deklaratime në seancë, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe duke u mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se Sektori i Pranimit Qendror subjektit në procedurë i ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sipas Deklaratës Unike të lartcekur, duke caktuar vlerë të re doganore, ndërsa në proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave ka cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së gjashtë të vlerësimit sipas nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme nga tregtare. Kërkesën për rishqyrtim të vendimeve e ka refuzuar me arsyetim se Dogana e Kosovës konstaton se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejt kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që lidhur me vlerën e këtij lloj të mallit janë hulumtuar çmimet në tregun vendor për mallin me origjinë nga i njëjti vend sikurse malli lëndor kontestues dhe është caktuar vlera e këtij malli nga Sektori i Vlerës që aplikohet për të gjitha subjektet që importojnë këtë lloj të mallit dhe që konsiderohet vlerë reale e mallit që do të caktohet për të gjithë njëllojë, andaj në këtë kuptim subjektit në procedurë me të drejtë i është rivlerësuar malli, pasi që ka deklaruar vlerën e mallit dukshëm më të ulët se vlera reale e mallit. Dogana e Kosovës ka konstatuar se kërkesa është e pathemeltë sepse sektori i pranimit qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar, apo që ka për t'u paguar për mallin e

shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Po ashtu sektori i pranimit qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën e gjashtë(6) të vlerësimit nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, derisa caktimi i vlerës së mallit bazuar në të dhënat e disponueshme, gjithmonë duke pas parasysh që Sektori i Vlerës në vazhdimësi ka përcjellë ndryshimet e çmimit në tregun vendor për mallin kontestues, andaj në bazë të këtyre ndryshimeve përkatësisht karakteristikave të ngjashme të mallit, kanë përcaktuar çmimin për mallin lëndor (ID 44) ka të përcaktuar vlerën e veshmbathjeve të përdorura në kg, ku nga e gjithë kjo vie në përfundim që jo vetëm subjektit në procedurë por edhe importeve të zhdoganuara për mallin e njëjtë me të gjitha karakteristikat e njëjta.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit, neni 33 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, paditësi në këtë rast do të duhej të dëshmonte vlerën e transaksionit të paguar shitësit-eksportues të mallit lëndor, Zodo Tire Co. Limited. Edhe pse pala paditëse i ka paraqitur gjykatës prova materiale si deklaratat doganore, faturat e mallit dhe konfirmimet swift, ajo nuk ka arritur të dëshmojë pagesën e mallit lëndor, gjë që do të vërtetonte se është deklaruar vlera reale e mallit doganor. Për këtë arsye, gjykata konstaton se dokumentacioni shoqërues i paraqitur nga paditësi është i pamjaftueshëm për të vërtetuar pretendimin se është paguar vlera reale e mallit lëndor.

Megjithëse pala paditëse i ka paraqitur gjykatës provat materiale, si faturat CI21080667-D të datës 29.08.2021, CI21080667-C të datës 29.08.2021, CI21080667-B të datës 29.08.2021, CI21080667-A të datës 29.08.2021, konfirmimet swift të pagesave të datave 13.07.2021 dhe 01.11.2021, faturat 21100250-c të datës 25.10.2021, 21100250-a, transferin bankar të datës 24.06.2021, konfirmimin swift të datës 16.11.2021, faturat 21100389-b dhe 21100389-d, dhe konfirmimet swift të datës 25.11.2021, gjykata vlerëson se këto dokumente nuk janë të harmonizuara me njëra-tjetrën as në kuptim të vlerës dhe as të përshkrimit të pagesës, për të bërë ndërlidhjen me faturat kontestuese.

Përshkrimet në konfirmimet swift janë kontradiktore me faturat e lartcekura: përshkrimi i datës 13.07.2021 përmban përshkrimin "pagesë për goma", ai i datës 01.11.2021 përmban përshkrimin "pagesa e pjesës së fundit të faturave nr. CI21080667-A-B-C DH", mirëpo mungojnë pagesat paraprake, përshkrimi i datës 24.06.2021 është "pagesa avans për goma", ai i datës 16.11.2021 "pagesa e faturave nr. 21100250 A – 21100250C dhe 21100250 E", mirëpo nuk pasqyron çmimin

total nga faturat në fjalë, ndërsa përshkrimi i datës 25.11.2021 përmban përshkrimin "pagesa e pjesës së fundit të faturave 21100389 B dhe 21100389 D" e që edhe kësaj i mungon pjesa tjetër e pagesave. Andaj, këto dokumente nuk mund të pranohen si të harmonizuar dhe gjykata i trajton sikur të mos ketë fare transaksione bankare, duke përjashtuar kështu aplikimin e nenit 33, paragrafi 1 të KDA-së.

Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës posedon mallra të ngjashme të zhdoganuara në periudhë të afërt kohore me mallin lëndor kontestues e që kanë ndikuar që e njëjta si fakte vendimtare i ka marr për bazë gjatë rivleresimit të mallit lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, Gjykata vlerëson se provat e tilla me të cilat është rivlerësuar malli lëndor sipas të dhënave të disponueshme tregtare, është provë e bazuar për tu vlerësuar malli lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, prandaj gjykata konstaton se është aplikuar drejt dispozita ligjore kur është rivlerësuar malli lëndor sipas të dhënave të disponueshme tregtare.

Gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se nga pretendimet e fakteve të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, nuk janë paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin vlerën e transaksionit të mallit lëndor.

Andaj, gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Neni 43, par 1. i LKA-së, *"Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative"*, Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se paditësi as në këtë kontest tregtar-administrativ nuk ka arritur që të paraqes fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij, ngase me nenin 7.1 të LPK-së, përcaktohet se *"Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla"*. Ndërsa me nenin 319.1 të LPK-së përcaktohet se *"Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta"*. Andaj, nga kjo gjendje faktike gjykata vlerëson se aktvendimi i të paditurës nr.01.3.2.2/293915-2021 i datës

02.03.2022, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e subjektit në procedurë, këtu paditësit, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Rrjedhimisht, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Nga të lartcekurat, Gjykata konform nenit 43 parag, 1, dhe nenit 46, parag. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjy

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.614/22, datë 29.08.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomës së shkallës së parë të kësaj Gjykate.